



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr. 2603/prot.

Himarë, më 17.05.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. 13 datë, 17.05.2024

**“PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUdhËN  
1- 30 PRILL 2024, NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6% I BLOK-NDIHMËS  
EKONOMIKE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” të ndryshuar, pikës 6, kreu II të vendimit nr. 955, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 %”.

Për familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga sistemi i pikëzimit i ndihmës ekonomike, drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, pasi bëri verifikimet përkatëse të dokumentacionit të paraqitur, konkludoi se këto familje përfitojnë ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 %.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Himarë të miratojë në total ndihmë ekonomike për 6 familje me një fond 17.933 lekë të ndara sipas njërive administrative si më poshtë:

**- PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË HIMARË**

Përfitojnë nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike 6% për muajin prill 2024 në Himarë 3 familje me një fond 8470 lekë, si më poshtë:

- 1-Fotika Petro Buta – Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
- 2-Thanasia Mihal Buta – Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
- 3- Rina Foto Rexhollari – Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme

**- PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE LUKOVË**



Përfitojnë nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike 6% për muajin prill 2024 në Lukovë 3 familje me një fond 9.463 lekë.

- 1- Dashuri Zaim Braushi Nuk ka marrë pikët e mjaftushme.
- 2- Simon Jorgo Kanani Nuk ka marrë pikët e mjaftushme.
- 3- Mark Ndue Gjini Nuk ka marrë pikët e mjaftushme.

**- PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE HORË-VRANISHT**

Përfitojnë nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike 6% për muajin prill 2024 në Hore – Vranisht 0 familje me një fond 0 lekë.


**PUNONJËS I NDIHMËS EKONOMIKE**

Zamira Xhani



**DREJTORIA JURIDIKE**

Ardit Muhametaj



**KRYETAR I BASHKISË**

Blerina Bala

